



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM
Nr. 423, datë 30.07.2024
PËR

PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË TRANSFERIMIT TË PÛRKOHSHËM ME
PËLQIM PËR GJYQTARIN Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin të tij nr. 102, datë 29.02.2024, “Për përsëritjen e transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, në kushtet kur verifikohet që gjyqtari i transferuar me pëlqim, të jetë transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin z. {...}.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.07.2024.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR